

UDHËZIM PËR VLERËSIM

VËREJTJE: Gabimet në gramatikë duhet anashkaluar, vetëm nëse është qëllimi i detyrës kontrollimi i rregullës së caktuar gramatikore ose drejtshkrimore.

DETYRA 1: Nxënësi/nxënësja* merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin 2 - nëpunës

DETYRA 2: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar se njerëzit e kishin vështirë t'i mbanin mend ato shënimet e bezdisshme në të cilat ka mjaft numra (të dhëna), prandaj u duhej t'i shënonin./Ajo që ishte interesante nuk duhej të shënohej sepse e mbanin mend njerëzit, dhe shënonin vetëm shënimet e bezdisshme të cilat ishte vështirë për t'i mbajtur mend./Për të mos i mbajtur mend shënimet aq të bezdisshme./ Ajo që ishte e bezdisshme, nuk e mbanin mend./Gjërat që nuk janë interesante shënohen.

Ose citon: *Nuk duhet të na çudis që këto tekste janë të bezdisshme, sepse ajo që ishte interesante, nuk duhej të shënohej – njerëzit i mbanin mend ato.*

Nxënësi merr **0 pikë** nëse jep një përgjigje të pacaktuar dhe të paplotë: p.sh. Sepse e kishin më lehtë t'i shënonin ato./ sepse njeriu i parë për të cilin dihej merrej me punët e bezdisshme të kontabilitetit.

DETYRA 3: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Në të dy librat e serialit: *Ne të pandalshmit/ Si e kemi pushtuar botën dhe përse bota nuk është e drejtë/ Librat e serialeve./ Seriali./ Ne të pandalshmit.*

Nxënësi merr **0 pikë** nëse cek vetëm një libër ose me përgjigjet e sakta shkruan edhe përgjigjen e pasaktë, p.sh. libri *Sapiens*.

DETYRA 4: nxënësi merr **1 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë: P, S, S, S.

DETYRA 5: gjithsej **2 pikë:**

Nxënësi merr 2 pikë nëse ka cekur 2 fakte nga më poshtë:

- *Përse bota nuk është e drejtë* – është gjendur në listën e bestsellerëve të magazinës *New York Times*/ Libri i tij gjendej në listën e bestsellerëve. / Bestseller
- librat e tij janë përkthyer në 65 gjuhë/janë përkthyer në shumë gjuhë
- librat janë shitur në 40 milionë kopje/janë shitur në dhjetëra milionë kopje
- e konsiderojnë njërin nga intelektualët më të angazhuar publikisht në kohën e sotme/ intelektual i dalluar

*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
QERSHOR, VITI MËSIMOR 2024-2025

Vërejtje: Nxënësi merr 2 pikë edhe nëse të dy të dhënat i shkruan mbi një vijë.

Nxënësi merr 1 pikë nëse ka cekur vetëm një fakt.

Nxënësi merr 0 pikë nëse shkruan një të dhënë të parëndësishme.

DETYRA 6: gjithsej **2 pikë:**

Nxënësi merr **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë (nga 1 pikë për të dy të dhënat e shkruara saktë në rend)

Vepra letrare	Autori	Personazhi	
<i>Kurora e maleve</i>	<i>Petar Petroviq Njegosh</i>	Vuk Mandushiqi	<i>1 pikë</i>
Tom Sojeri	<i>Mark Tueni</i>	<i>Tomi</i>	<i>1 pikë</i>

DETYRA 7: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin 3 - pajtuese dhe krenare

DETYRA 8: gjithsej **2 pikë:**

Nxënësi merr **2 pikë** nëse jep një shpjegim më të plotë që sjell në lidhje jetën e mëparshme dhe jetën e tashme të zonjës Loazel, flet për ndryshimin e jetës së zonjës Loazel, shpjegon motivimin për veprimet e saja para dhe pas humbjes së gjerdanit.

Nxënësi merr **1 pikë** nëse jep një përgjigje në të cilën nuk sjell në lidhje jetën e mëparshme me jetën e tashme të zonjës Loazel, por vetëm thekson p.sh. pasojat e humbjes së gjerdanit.

Nxënësi mer **0 pikë** nëse jep një përgjigje të pasaktë ose të pacaktuar.

DETYRA 9: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka përshkruar fjalitë/fjalinë: "Sa e çuditshme, e ndryshueshme është jeta! Sa pak i duhet një njeriu që të humbasë apo të shpëtohet!"/ "Sa e çuditshme, e ndryshueshme është jeta!"/ "Sa pak i duhet një njeriu që të humbasë apo të shpëtohet!"

Vërejtje: *Pranohet edhe nëse nxënësi perfrazon një apo të dyja fjalitë e cituara.*
Nxënësi merr **0 pikë** nëse përgjigja është e pasaktë ose e parëndësishme.

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
QERSHOR, VITI MËSIMOR 2024-2025

DETYRA 10: gjithsej **2 pikë**:

- A) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: epikës/poezisë epike/gjinisë së letërsisë epike
- B) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka nënvizuar (ose ka përshkruar) fjalinë: *E krehur keq, me fundet e lidhura shtrembër dhe me duar të kuqe, fliste me zë të lartë dhe lante enët me ujë të nxehtë.*

DETYRA 11: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin 3- *krahasimi*

DETYRA 12: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Me paraqitjen e krijesave mitologjike (zanave dhe orëve)*

DETYRA 13: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Mbartje*

DETYRA 14: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Mbartje*

Realizohet në dialog.	<u>E</u>
Është formal (zyrtar).	<u>E</u>
Plotësohet me gjeste dhe me mimikë.	<u>E</u>
Fjalitë i ka më të gjata dhe më të ndërlikuara.	<u>Sh</u>

DETYRA 15: gjithsej **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

Ndarë dhe shkruar saktë fonemat zanore: *a-ë; e-ë; y-i.*

Ndarë dhe shkruar saktë fonemat bashkëtingëllore: *b-j; c-p; d-r; rr-t; xh-m.*

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka ndarë dhe shkruar saktë ose fonemat zanore ose fonemat bashkëtingëllore.

DETYRA 16: gjithsej **2 pikë** për të gjitha përgjigjet plotësisht të sakta:

Taulanti bleu dy bileta për ndeshjen e futbollit.

Doli për të shëtitur nëpër rrugët e qytetit.

Ata i përsëritën shokët kur i takojnë në rrugë.

Ne u nisëm nga shkolla në orën 12.

Ai u zgjua shumë herët në mëngjes.

Nxënësi merr **1 pikë** katër folje të përdorura saktë në kohën e kryer të thjeshtë.

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
QERSHOR, VITI MËSIMOR 2024-2025

DETYRA 17: gjithsej **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

- A) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Në mbrëmje e përgatis
çantën për në mëngjes*
- B) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar saktë shkurtesat:
e të tjera -etj.; për shembull -p.sh.

DETYRA 18: gjithsej **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

1. nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Lexo tekstin nga faqja
pesëmbëdhjetë deri në faqen tridhjetë e nëntë.*
2. nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Sot kemi mësuar për Luftën
e Dytë Botërore.*

DETYRA 19: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka nënvizuar ose rrethuar fjalën e shkruar saktë: batanije

DETYRA 20: Skema e vlerësimit të hartimit ***Loja shoqërore e preferuar***
Vërejtje: Hartimi lexohet edhe nëse është shkruar ose është filluar të shkruhet në vendin e parshikuar për planin e hartimit.

Përmbajtja – 10 pikë

Kërkesa 1.

Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan për (jo) popullaritetin e lojërave shoqërore sot.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 2.

Nxënësi merr 1 pikë nëse përshkruan shkurt lojën shoqërore të cilën e ka zgjedhur.

Nëse cek imtësitë dhe detajet, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
QERSHOR, VITI MËSIMOR 2024-2025

Kërkesa 3.

Nxënësi merr 1 pikë nëse cek se me kë dëshiron të luaj më së shumti lojën e zgjedhur shoqërore dhe shkurtimisht shkruan përse.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 4.

Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan shkurt për ndjenjat e veta/ndjenjat gjatë lojës kur humb apo fiton.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 5.

Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan shkurt për ndikimin e lojës në jetën e përditshme (p.sh. argëtim/relaksim/pranim i humbjes/nxitje e përmirësimit të rezultatit/mposhtjes së pengesave/kontrollit të emocioneve/punës në ekip/humbjes së kohës/nervozizmit për shkak të humbjes...)

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Gjuha dhe struktura e tekstit - 8 pikë

Leksiku	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura e tekstit
→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, zgjedhja përkatëse e fjalëve, leksiku i pasur 2 pikë	<u>GRAMATIKA</u> → respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, formave gramatikore, kongruencës) 2 pikë <u>DREJTSHKRIMI</u>	→ renditja e natyrshme e të dhënave të ofruara, lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit dhe pjesëve të tij 1 pikë	→ përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe formës së tekstit strukturës së tij logjike 1 pikë

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
QERSHOR, VITI MËSIMOR 2024-2025

→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, leksiku i varfër dhe përsëritja e shprehjeve pjesërisht e saktë 1 pikë	→ respektimi i normës drejtshkrimore (përdorimi i drejtë i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe i shenjave bazë të pikësimit, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit) 2 pikë Gjithsej 4 pikë <u>GRAMATIKA</u> → respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet semantike...) pjesërisht e saktë - 1 pikë <u>DREJTSHKRIMI</u> → respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të vogla (gabimet e vogla në shenjat e pikësimit: presja te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse,	→ s' është i lidhur në nivel të tekstit dhe pjesëve të tij 0 pikë	
---	--	--	--

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
QERSHOR, VITI MËSIMOR 2024-2025

	respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit) pjesërisht e saktë - 1 pikë Gjithsej 2 pikë		
--	---	--	--